



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 83.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 5 të Rregullës Zgjedhore Nr.16/2013, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 07.08.2017, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet kërkesa e votuesve të lagjes Suhodoll i Poshtëm, Suhodoll i Epërm dhe Lagjes së Doktorëve për të votuar në komunën e Mitrovicës së Jugut.
 - a) Lagjet Suhodoll i Poshtëm, Suhodoll i Epërm dhe Lagja e Doktorëve duhet të mbesin në qendrën aktuale të votimit, në shkollën fillore Paralele e Ndarë "Azis Sylejman" që si objekt shkollor menaxhohet nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, ku kjo qendër e votimit do të marrë kodin e komunës së Mitrovicës së Jugut, dhe
 - b) Për votuesit e Lagjes së tre rrokaqiejve dhe Lagjes 7 shtatori, do të hapet një qendër e votimit afër këtyre dy lagjeve, në shtëpi private, e cila është identifikuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve të Mitrovicës së Veriut.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 07.08. 2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

